



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ALMA POSHI
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE
NR. 5, RRUGA SULEJMAN DELVINA,
APARTAMENTI 2
TEL: 0684043695

KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME (KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 1641

Nr. koleksioni: 512

Tirane më 17/08/2021



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë"



A2021053820059835588



A2021053820059835588

KONTRATË DHURIMI KUOTASH KAPITALI

Sot, më datë 17 gusht 2021, para meje Notere ALMA POSHI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tiranë, NJESIA ADMINISTRATIVE NR. 5, RRUGA SULEJMAN DELVINA, APARTAMENTI 2, u paraqiten personalisht palet kontraktuese:

DHURUES:

GEZIM ALIAJ, atësia MARK, amësia Fusha MemesiPale, shtetas Britanik, lindur në KRUSH E MADHE dhe banues në GBR, me adresë 213 Westfield, Harlow, Cm18 6aw, lindur më 05/05/1977, gjendja civile "I MARTUAR", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. dhe nr. personal 562431144, .

(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "Dhuruesi")

PRANUES I DHURIMIT:

Antoneta Cingërrima, atësia Ylli, amësia Shkëndi, shtetase Shqiptare, lindur në Baltez, Gramsh dhe banuese në Tiranë, me adresë Bilal Golemi; Nd. 1845; H. 0; Ap. 237; Njësia Administrative Nr. 5; Tiranë; 0000; Tiranë, lindur më 12/01/1978, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 034193771 dhe nr. personal H85112165V, .

(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "Përfituesi i dhurimit")

Une, noterja pasi verifikova identitetin e paleve pjesmarrese nga dokumenti i identifikimit të paraqitur prej tyre dhe pasi konstatova se i kane të gjitha aftësitë ligjore, (madhore dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar), u bera të qarte paleve kërkesat e ligjit për rastin konkret, i njoha me të drejtat dhe detyrimet e tyre të parashikuara në nenin 716 e vijues të K. Civil; Neni 73/ç e vijues i Ligj nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare", Ligj Nr.131/2015 Për Qendren Kombëtare të Biznesit.

kushtet paraprake:

- A) Dhuruesi **Gezim Aliaj** është ortak dhe zotëron 1 (një) kuotë të barabartë me 15%(pesëmbëdhjete - përqind) të kapitalit themeltar të **Shoqërisë "Real Construction Group" shpk**, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me (NUIS) L81931015U, me seli në Tiranë, Kashar, Yzberish, Rruga Tre Deshmoret, Pallati në Zone Kadastrale 8240, nr. pasurie 1/284, kt. 2 (në vijim referuar edhe si "Shoqëria");
- B) Pranuesi i **Antoneta Cingërrima** është ortak dhe zotëron 1 (një) kuotë të barabartë me 85%(tetëdhjete e pese - përqind) të kapitalit themeltar të **Shoqërisë "Real Construction Group" shpk**, regjistruar pranë QKB me (NUIS) L81931015U, me seli në Tiranë, Kashar, Yzberish, Rruga Tre Deshmoret, Pallati në Zone Kadastrale 8240, nr. pasurie 1/284, kt. 2 (në vijim referuar edhe si "Shoqëria");
- C) Dhuruesi dëshiron t'i dhurojë Pranuesit të Dhurimit kuotat që ai zotëron 15% (pesëmbëdhjete përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë, (në vijim referuar edhe si "Kuota"), sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në vijim;



A2021053820059835588

- D) Pranuesi i Dhurimit është dakort të pranojë dhurimin nga Dhuruesi te Kuotes se barabartë me 15% (pesëmbëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë, sipas kushteve dhe afateve të mëposhtme;
- E) Palët deklarojnë dhe pranojnë shprehimisht se përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate, të gjithë ortakët e Shoqërisë kanë nënshkruar vendimin e mbledhjes se asamblese se pergjithshme numer 2 date 17.8.2021 per transferimin/dhurimin e kuotave nga dhuruesi tek pranuesi i dhurimit.

Meqë ekzistojnë kushtet paraprake, Palët, pranojnë të lidhin dhe në fakt lidhin këtë Kontratë sipas kushteve të mëposhtme:

**Neni 1
kushtet paraprake**

1.1 Kushtet paraprake janë pjesë përbërëse dhe thelbësore të kësaj Kontrate.

**Neni 2
objekti i kontratës**

2.1 Objekt i kësaj kontrate është transferimi me ane te dhurimit i kuotes se Dhuruesit **Gezim Aliaj** i cili deshiron te dhuroje, te transferoje dhe dorezoje kuoten/pjesen e tij te barabarte me 15%(pesëmbëdhjetë përqind) te kapitalit themeltar qe zoteron ne shoqerine "**Real Construction Group**" shpk të lirë nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë parablerje apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve, në favor të Pranuesit te Dhurimit **Antoneta Cingërrima**, e cila, pranon dhurimin sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë Kontratë.

**Neni 3
efektet e transferimit**

- 3.1 Transferimi i titullit te kuotes do te behet menjehere pas nënshkrimit te kesaj kontrate.
- 3.2 Pas nënshkrimit të kësaj Kontrate, Pranuesi i Dhurimit se bashku me kuotat e tij ne kete shoqeri, behet zoterues i 100(njeqind) % (përqind) te kapitalit themeltar te Shoqërise "**Real Construction Group**" shpk.
- 3.3 Nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate, Pranuesi i Dhurimit ushtron të gjitha të drejtat që ligji i njej zotëruesit të kuotave të përcaktuara në objektin e kësaj kontrate, si nga pikëpanja e ushtrimit të të drejtës së votës dhe të pjesmarrjes në shpërndarjen e fitimit.
- 3.4 Pranuesi i Dhurimit mori dijeni te regjistrojë këtë kontratë prane Regjistrit Tregtar brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.

**neni 4
garancitë**

4.1 Dhuruesi i jep Pranuesit te Dhurimit të gjitha garancitë që parashikohen në Kodin Civil të R. Sh. për Dhuruesin, si dhe e garanton Pranuesin e Dhurimit për gëzimin e qetë të titullit të pronësisë.

**neni 5
dispozita të pergjithshme**

- 5.1 Kjo kontrate eshte e detyrueshme dhe sjell pasoja juridike ndaj paleve dhe trashegimtareve te tyre.
- 5.2 Çdo ndryshim i kësaj kontrate është i vlefshëm vetëm nëse është nënshkruar rregullisht nga palët, vetëm atëhere do të konsiderohet pjesë përbërëse e kësaj kontrate.
- 5.3 Per sa i perket ceshtjeve qe kjo kontrate nuk i rregullon shprehimisht, ato do te rregullohen nga dispozitat e Kodit Civil dhe legjislacioni shqiptar ne kete fushe.



A2021053820059835588

5.4 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj kontrate midis dy palëve, do të zgjidhen me bisedime dhe mirëkuptim të ndërsjelltë midis palëve, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

5.5 Me këtë kalim kuotash është dakort dhe jep pelqimin edhe bashkeshortja e Dhuruesit, zj. Lume Aliaj, e datelindjes 23.02.1977, lindur në Piskot, Gjakovë, banuese në Angli, identifikuar me dokument identifikimi Pasaportë GBR nr. 562193519, person madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

Kontrata e kalimit të të drejtave, u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontraktuese, të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve kontraktuese nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

DHURUESI

GEZIMI ALIAJ

Dhënësi i Pelqimit

PRANUESI I DHURIMIT

Antoneta Cingerrimo

NOTERE

Lume Aliaj

#

Alma Foshi

Alma Foshi





REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kërkimit: D-20210817153710479
Data e Rezultatit të Kërkimit: 17.08.2021
Ora e Rezultatit të Kërkimit: 3:37:10PM
Lloji i Kërkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-043-1973
Referenca e Përdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0

GEZIM MARK ALIAJ

Eldo Kemerli

